



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 31 tetor 2024

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme në normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: shtator 2024

- Norma mesatare e interesit të totalit të kredive në shtator 2024 është 5,41% dhe shënoi rënie mujore dhe vjetore prej 0,03 p.p., respektivisht 0,08 p.p. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave është rritur në bazë mujore dhe vjetore për 0,05 p.p., respektivisht 0,42 p.p., dhe është 2,01%.
- Në shtator, norma mesatare e interesit të kredive të sapo miratuara² shënoi rënie mujore dhe vjetore prej 0,06 p.p., respektivisht 0,51 p.p., dhe është 4,98%. Norma mesatare e interesit për depozitat e sapo pranuar është më e lartë për 0,17 p.p., respektivisht 0,45 p.p., në bazë mujore dhe vjetore dhe është 2,60%.

Tabela 1. Norma e interesit të totalit të kredive dhe depozitave të reja

	9.2023	10.2023	11.2023	12.2023	1.2024	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024	7.2024	8.2024	9.2024
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.49	5.49	5.48	5.47	5.55	5.52	5.50	5.51	5.49	5.47	5.46	5.44	5.41
Korporatat	5.37	5.37	5.36	5.33	5.44	5.40	5.65	5.35	5.31	5.26	5.23	5.20	5.15
Amviseritë	5.61	5.60	5.59	5.59	5.65	5.64	5.35	5.65	5.65	5.66	5.67	5.66	5.66
Kreditë e reja	5.49	5.55	5.38	5.21	5.22	5.35	4.98	5.47	5.19	5.08	5.12	5.04	4.98
Korporatat	5.50	5.71	5.39	5.30	5.21	5.25	5.40	5.57	5.16	4.95	4.96	4.90	4.78
Amviseritë	5.47	5.28	5.35	5.02	5.26	5.45	4.73	5.33	5.26	5.29	5.34	5.28	5.27
Depozitat	1.59	1.67	1.74	1.79	1.72	1.76	1.80	1.82	1.86	1.88	1.93	1.96	2.01
Korporatat	1.94	1.96	2.23	2.06	2.07	2.08	1.76	2.11	2.21	2.25	2.28	2.20	2.34
Amviseritë	1.55	1.64	1.69	1.76	1.69	1.73	2.12	1.79	1.81	1.84	1.89	1.93	1.97
Depozitat e reja	2.15	2.32	2.28	2.37	2.22	2.31	2.46	2.54	2.36	2.52	2.76	2.43	2.60
Korporatat	1.65	1.51	1.71	2.19	2.02	2.19	2.42	2.61	2.38	2.39	3.03	1.99	2.14
Amviseritë	2.40	2.57	2.46	2.42	2.30	2.35	2.52	2.52	2.36	2.55	2.68	2.76	2.79

Burimi: BPRMV.

¹ Me "normë interesi" nënkuptohet normë e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shih metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf



² Lidhur me normat e interesit të kredive të sapo miratuara / depozitat e reja janë karakteristike lëvizje të ndryshueshme. Lëvizjet e këtyre normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord e interesit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës



1. Normat e interesit në sektorin korporativ³

- Norma mesatare e interesit të totalit të kredive të sektorit korporativ, në shtator shënoi rënie mujore prej 0,05 p.p. dhe është 5,15%. Në të njëjtën kohë, ndryshimi mujor është rezultat i rënies në të gjithë komponentët: normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,09 p.p.) dhe normat e interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,05 p.p., respektivisht 0,03 p.p.). Në krahasim me shtatorin e vitit të kaluar, kjo normë interesi është më e ulët për 0,22 p.p.



Burimi: BPRMV.

- Në shtator, norma e interesit për kreditë e sapomiratuara për sektorin korporativ është ulur për 0,12 p.p. në baza mujore dhe është 4,78%. Nga aspekti i strukturës së valutës, rënia mujore është rezultat i rënies të normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore dhe normave të interesit të kredive në valutë të huaj (0,73 p.p., respektivisht 0,19 p.p.), në kushte të rritjes së normës së interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,02 p.p.). Në bazë vjetore, norma e interesit për kreditë e sapomiratuara për sektorin korporativ shënoi ulje prej 0,72 p.p.



Burimi: BPRMV.



³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jo financiare (publike dhe të tjera).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave të sektorit korporativ, këtë muaj është 2,34%, që paraqet rritje mujore prej 0,14 p.p. Ndryshimi në rritje është rezultat i rritjes së normave të interesit për depozitat në denarë pa klauzolë valutore dhe normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,16 p.p., respektivisht 0,13 p.p.), ndërsa normat e interesit për depozitat në denarë me klauzolë valutore shënuan rënie (për 0,06 p.p.). Analizuar në bazë vjetore, kjo normë e interesit shënoi rritje prej 0,40 p.p.
- Në shtator, norma e interesit për depozitat e sapo pranuar⁴ të sektorit korporativ, është më e lartë për 0,15 p.p. krahasuar me muajin paraardhës dhe është 2,14%. Ndërkaq, rritja mujore është rezultat i rritjes së normave të interesit për depozitat në denarë pa klauzolë valutore (për 0,34 p.p.), me rënie të vërejtur të normave të interesit për depozitat në valutë të huaj (për 0,20 p.p.). Njëkohësisht, norma e interesit e depozitave në denarë me klauzolë valutore është 1,90% për ndryshim nga muaji i kaluar kur bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar depozita të këtij lloji. Norma e interesit për depozitat e sapo pranuar të sektorit korporativ është më e lartë për 0,49 p.p. në nivel vjetor.

2. Normat e interesit për amvisëritë⁵



Burimi: BPRMV.

- Këtë muaj, norma e interesit e totalit të kredisë për amvisëritë është 5,66% dhe është e pandryshuar në bazë mujore. Krahasuar në bazë vjetore, kjo normë interesi shënoi rritje prej 0,05 p.p.


⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵ Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Norma mesatare e interesit për kreditë e sapomiratuara për amvisëritë, në shtator shënoi rënie mujore prej 0,01 p.p. dhe është 5,27%. Ndryshimi në rënie vjen si pasojë e uljes së normave të interesit për kreditë në denarë pa klauzolë valutore dhe e normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,12 p.p., përkatësisht 0,11 p.p.), në kushte të rritjes së normave të interesit për kreditë në denarë me klauzolë valutore (për 0,03 p.p.). Norma mesatare e interesit të kredive të sapo miratuara për amvisëritë është ulur për 0,20 p.p. krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.



Burimi: BPRMV.



- Në shtator, norma e interesit në totalin e depozitave për amvisëritë shënoi rritje mujore prej 0,04 p.p. dhe është 1,97%. Rritja mujore është rezultat i rritjes së normave të interesit për depozitat në denarë pa klauzolë valutore dhe për normat e interesit për depozitat në valutë të huaj (për 0,05 p.p., respektivisht 0,03 p.p.), në kushtet e normave të interesit të pandryshuara për depozitat në denarë me klauzolë valutore. Në nivel vjetor, kjo normë interesi është rritur për 0,42 p.p.
- Te normat e interesit të depozitave të sapo pranuar të amvisërive⁶, në shtator është shënuar rritje mujore prej 0,03 p.p. dhe është 2,79%. Ndryshimi është rezultat i rritjes së normës së interesit për depozitat në denarë pa klauzolë valutore dhe për normat e interesit për depozitat në valutë të huaj (për respektivisht 0,02 p.p.). Në të njëjtën kohë, këtë muaj, në bankat dhe kursimoret nuk janë regjistruar depozita të sapo pranuar në denarë me klauzolë valutore. Në raport me shtatorin 2023, norma e interesit e depozitave të sapo pranuar për amvisëritë është më e lartë për 0,39 p.p.

⁶ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të sapo pranuar të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve:

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 29 nëntor 2024 (mesatarja referuese, përfshirë).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02/3215-235 lok. 108/110.